

## HETIMI I BROOK HOUSE

### Cili është qëllimi i Hetimit të Brook House?

Ne jemi duke hetuar keqtrajtimin e personave të ndaluar në Brook House IRC (Qendra e Largimit të Imigrantëve) ndërmjet datës 1 Prill 2017 dhe 31 gusht 2017. 'Keqtrajtim' do të thotë trajtim në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Qëllimi i Hetimit është përcaktimi i shkallës së keqtrajtimin në Brook House IRC gjatë periudhës kohore të përshkruar në [Përkufizimet e Referencës](#). Hetimi do të përcaktojë përgjegjësinë për keqtrajtimin në fjalë dhe nëse kanë kontribuar dështimet sistemike. Nëpërmjet mbledhjes së provave dhe seancave dëgjimore publike, Hetimi do të përcaktojë përgjegjësinë për ngjarjet në Brook House IRC dhe, nëpërmjet publikimit të një raporti, do të bëjë rekomandime që të gjitha organizatat përkatëse të mund të nxjerrin mësim nga ato që kanë ndodhur.

### I pavarur nga shteti

Ky hetim është një hetim i pavarur i rregulluar me ligj që merr në shqyrtim ngjarjet në Brook House IRC ndërmjet datave 1 Prill 2017 dhe 31 Gusht 2017.

- Të qenit i pavarur do të thotë se Hetimi nuk është pjesë e qeverisë dhe nuk drejtohet nga një departament qeveritar;
- I rregulluar me ligj do të thotë se Hetimi është shndërruar nga një hetim ekzistues në një Hetim kërkimor në bazë të Ligjit të Hetimeve Kërkimore 2005 dhe ka kompetencën të detyrojë dëshmitarët të japin prova (dëshmi) dhe të paraqesin dokumente.

### Si të na kontaktoni

A keni qenë i ndaluar në Brook House IRC ndërmjet datave 1 Prill 2017 dhe 31 Gusht 2017? Nëse po, ne duam të dëgjojmë nga ju. Mund të na kontaktoni duke përdorur [Formularin tonë të Kontaktit](#) ose me anë të një nga metodave si më poshtë:

**Telefon:** [0800 181 4363](tel:08001814363)

**Email:** [enquiries@brookhouseinquiry.org.uk](mailto:enquiries@brookhouseinquiry.org.uk)

**Shkruani:** (POSTËN E PAGUAN MARRËSI)

## Freepost BROOK HOUSE INQUIRY

### A duhet të kontaktojë me ju në anglisht?

Nëse preferoni të komunikoni në një gjuhë tjetër ndryshe nga anglishtja, ju lutemi na tregoni dhe ne mund ta organizojmë që t'ju flasim përmes shërbimit tonë të përkthimit.

### Dua të marr pjesë në Hetim

Nëse tashmë keni një avokat që vepron në emrin tuaj, ju lutemi flisni me të rreth faktit për tu bërë një pjesëmarrës kryesor. Nëse ende nuk keni një avokat ose nuk na keni kontaktuar tashmë, ju lutemi na kontaktoni duke përdorur një nga metodat e mësipërme.

### Ku mund të gjej më shumë informacion?

Më shumë informacion mund të gjendet në faqen tonë të internetit, përfshirë datat e seancave [dëgjimore](#), informacione rreth adresës së [vendndodhjes](#) sonë dhe [lajme](#) rreth Hetimit Kërkimor.

### Organizata të dobishme

Fatkeqësisht, ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë ndihmë ose këshilla për imigracionin, gjë që është jashtë parametrave të këtij Hetimi Kërkimor. Nëse keni nevojë për ndonjë mbështetje në lidhje me statusin tuaj të imigracionit ose jeni të shqetësuar për mirëqenien tuaj, ju lutemi kontaktoni një prej organizatave më poshtë:

#### [Red Cross \(Kryqi i Kuq\)](#)

*Mund të ofrojë ndihmë urgjente për mirëqenien e refugjatëve dhe azilkërkuesve dhe viktimat e trafikimit njerëzor.*

[Bail for Immigration Detainees \(Lirim me Kusht për Imigrantët e Ndaluar\)](#) - Tel 020 7456 9750 (E Hënë – E Enjte 10:00– 12:00 në mesditë)

*Ofron këshilla ligjore dhe përfaqësim për imigrantët e ndaluar në qendrat e largimit dhe burgjet.*

[Migrant Help \(Ndihmë për Migrantët\)](#) - Linja telefonike pa pagesë për Azilin 0808 8010 503

*Ofron këshilla dhe ndihmë për Migrantët.*

[Medical Justice \(Ekspertizë Mjekësore\)](#) - Telefon 0207 561 7498

*Ofron këshilla dhe vlerësime të pavarura mjekësore për të ndaluarit nga imigracioni dhe harton raporte mjeko-ligjore dhe letra që përshkruajnë probleme të rëndësishme mjekësore.*

[Gatwick Detainees Welfare Group \(Grupi për Mirëgenien e të Ndaluarve në Gatwick\)](#) - Telefon 01293 657070

*Ofron mbështetje dhe miqësi për të ndaluarit që mbahen në Gatwick IRC dhe familjet e tyre.*

[Prisons & Probation Ombudsman \(Avokati i Popullit për Burgjet & Shërbimin e Provës\)](#) – Thirrje lokale në numrin e telefonit 0845 010 7938 (shërbimi i sekretarisë telefonike)

*Hetim i pavarur i ankesave të paraqitura nga ata që janë në burg ose mbahen në qendrën e ndalimit të imigrantëve.*

[Samaritans \(Samaritanët\)](#) -. ose Tel 116 123 pa pagesë

*Mbështetje falas për të dëgjuar ata që kanë nevojë.*

**Për të shkarkuar informacionin në PDF klikoni**